



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Tiranë, 29.06.2016

Lënda: Paraqitja e projektligjit “Për Rivlerësimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe procesi për shqyrtimin e tij nga Kuvendi

Drejtuar :

**z.Illir META
Kryetar i Kuvendit**

Në vëmendje :

Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit

I nderuar z. Kryetar,

Kuvendi, në zbatim të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 24 të Rregullores së tij, me vendimin nr.96/2014 ka vendosur ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

Komisioni i Posaçëm, ndër të tjera, ka për objekt të veprimtarisë së tij edhe: (iii) Propozimin për miratim të një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislativës, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese, e hartuar me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik (pika 2 e vendimit).

Për realizimin e detyrave të përcaktuara, pranë komisionit të posaçëm parlamentar, është ngritur dhe ka funksionuar Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i cili asistohet nga sekretariati teknik, detyra e të cilëve ndër të tjera ka qenë ajo për hartimin e projektligjeve të reformës në drejtësi (pikat 7 e 8 të vendimit).

KUVENDI		
Shenimi i Kryetarit _____		
Futja ne program Shqyrtimi ne seance		dt. _____ dt. _____ dt. _____

Në përputhje me vendimin nr.96/2014 dhe vendimmarrjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, Grupi i ekspertëve të Nivelit të Lartë, vendas e ndërkombëtarë, ka hartuar projektligjin “Për Rivlerësimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji, siç edhe është bërë e njohur publikisht përmes medias, i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimesh me ekspertë të fushës, me institucionet përkatëse të sistemit të drejtësisë, me grupet e interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile si dhe është bërë publik përmes faqes së internetit të reformës në drejtësi.

Në përfundim të të gjithë këtij procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, projektligji është dorëzuar/depozituar në fillim të muajit qershor në Komisionin e posaçëm parlamentar i cili e ka përfshirë në kalendarin e punës së tij për shqyrtim në parim, nen për nen dhe në tërësi (vendimi nr.20, datë 14.06.2016).

Ky komision në mbledhjen e tij të datës 20 qershor është njohur me përmbajtjen e projektligjit.

Komisioni ka caktuar relatorin për projektligjin dhe në mbledhjen e datës 6 korrik do të fillojë shqyrtimin në parim dhe nen për nen të tij, sipas kalendarit të punimeve të komisionit.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë (nenet 24, 29, 38, 39, 41, 68, 69 dhe 70) dhe në zbatim të detyrës së ngarkuar nga Vendimi nr.96/2014 të Kuvendit të Shqipërisë, do ta paraqesë projektligjin për shqyrtim e miratim në seancën plenare të përcaktuar në kalendarin e punës së Kuvendit.

Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të këtij projektligji së bashku me relacionin përkatës.

Me respekt

Fatmir XHAFAJ

Deputet

Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROJEKT LIGJ¹

Nr. _____, datë _____

PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit sipas nenit 179/b të Kushtetutës.

Neni 2

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton:

1. Parimet e organizimit të procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët;
2. Metodologjinë, procedurat dhe standardet e rivlerësimit;
3. Organizimin dhe funksionimin e institucioneve, Operacionit Monitorues Ndërkombëtar, si dhe rolin e publikut në procesin e rivlerësimit.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Komisioni” është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i parashikuar në Nenin 179/b, paragrafi 5, i Kushtetutës.
2. “Kolegji i Apelit” është Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit pranë Gjykatës Kushtetuese i parashikuar në Nenin 179/b, paragrafi 5, i Kushtetutës.

¹Versioni i datës 2016 06 27 AL

3. “Kryetar” është kryetari pranë çdo trupi gjykues në Komision ose në Kolegjin e Apelit;
4. “Institucionet e rivlerësimit” janë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posacëm i Apelit dhe Komisioneri Publik;
5. “Subjekt i rivlerësimit”, janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
6. “Vëzhgues ndërkombëtarë”² janë personat e caktuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, në përputhje me nenin B të Aneksit të Kushtetutës;
7. “Person i lidhur” janë rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, duke përfshirë çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit;
8. “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë patur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi;
9. “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipëri ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr.9049/2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”;
10. “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, të përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr.8338/1998, “Mbi të ardhurat”;
11. “Marrëdhënie biznesi” është çdo marrëdhënie profesionale ose tregtare, e cila lidhet me veprimtaritë e ushtruara nga subjektet e këtij ligji dhe klientët e tyre, që në çastin e vendosjes së saj, vlerësohet të jetë një marrëdhënie e vazhdueshme sipas ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
12. “Krim i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni” janë të gjitha veprat penale sipas nenit 75/a të Kodit Penal dhe ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.
13. “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person i cili është dënuar për kryerjen, pjesëmarrjen ose mbështetjen e një vepre penale, në Shqipëri ose jashtë saj, që ka të bëjë me aktivitetin e organizuar kriminal, duke përfshirë, pa u kufizuar, trafikimin e personave, kontrabandën e armëve, trafikimin e drogës, kultivimin e drogës, pastrimin e parave ose çdo krim tjetër në mbështetje të aktivitetit kriminal të organizuar. Person i përfshirë në krimin e organizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, konsiderohet çdo person që është dënuar, nga një shtet tjetër, për akuza të njëjta ose të ngjashme.
14. “Person i dyshuar si i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person i arrestuar, hetuar ose i akuzuar për kryerjen, pjesëmarrjen ose mbështetjen e një vepre penale, në Shqipëri ose jashtë shtetit, që ka të bëjë me aktivitetin e organizuar kriminal, duke përfshirë, pa u kufizuar, trafikimin e personave, kontrabandën e armëve, trafikimin e drogës, kultivimin e drogës, pastrimin e parave ose çdo krim tjetër në mbështetje të aktivitetit kriminal të organizuar.

²Duke patur parasysh që detyrat e operacionit ndërkombëtar të vëzhgimit janë parashikuar në Kushtetutë, nga këndvështrimi i teknikës legislative, në këtë ligj rregullohet roli konkret i vëzhguesve ndërkombëtarë në procesin e rivlerësimit.

Person i dyshuar si i përfshirë në krimin e organizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, konsiderohet çdo person që është arrestuar, hetuar ose akuzuar, nga një shtet tjetër, për akuza të njëjta ose të ngjashme.

15. “Kontakt i papërshtatshëm” është një takim, telefonatë, telekomunikim, vakt ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, jo-etik që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi ose marrëdhënie tjetër për subjektin e rivlerësimit.
16. “Periudha e rivlerësimit” është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit gjatë të cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale sipas këtij ligji;
17. “Organ i vlerësimit të aftësive profesionale” është Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që funksionon sipas ligjit nr.8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, struktura përkatëse e Prokurorisë së Përgjithshme ose institucionet që mund t’i zëvendësojnë ato;;
18. “Ligji për statusin” është Ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ;
19. “ILDPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili organizohet dhe funksionon sipas ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”;
20. SPAK është Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar e cila organizohet dhe funksionon sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”
21. “Dokument ligjor” është çdo dokument i përgatitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës profesionale, në veçanti vendim, raport/relacion, akt-akuzë, mendim ligjor, si dhe akte të tjera që provojnë aftësitë e tij profesionale.
22. Shprehja “nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike” do të thotë që nuk ka mbajtur pozicionin e funksionarit të kabinetit të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”
23. Shprehja “nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike” do të thotë që nuk ka qenë anëtar i një parti politike ose nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese i një partie politike.³
24. ‘Ditë’ nënkupton ditë kalendarike.

Neni 4

Objekti dhe parimet e procesit të rivlerësimit

1. Procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tre komponentëve:⁴

a) Vlerësimi i pasurive;

³ Neni 66 i ligjit nr. 152/2013 “Për nepunesin civil” parashikon se një shkaqet e lirimit nga sherbimi civil eshte të qenurit anetar i organeve drejtuese i nje partie politike.

⁴ Pjesërisht përsëritje e Kushtetutës dhe te nenin 6.

b) Kontrolli i figurës, dhe,

c) Vlerësimi i aftësive profesionale;

2. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit vendos bazuar në një ose disa prej komponentëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre komponentëve, ose në vlerësimin tërësorë të procedurave.

3. Procesi i rivlerësimit fillon menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Kur çështja është gati për t'u shqyrtuar, institucioni vendos në afatin më të shpejtë të mundshëm.

4. Çështjet për rivlerësimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe për Prokurorin e Përgjithshëm, do të trajtohen paraprakisht nga institucionet.

5. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, institucionet respektojnë parimin e procesit të rregullt ligjor bazuar veçanërisht, në ligjshmërinë, objektivitetin, barazinë para ligjit, proporcionalitetin dhe japin vendime brenda një afati të arsyeshëm.

6. Për kryerjen e veprimtarisë së tyre, institucionet zbatojnë procedurat e parashikuara në nenin 179/b të Kushtetutës dhe dispozitat e Aneksit të Kushtetutës, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe ligjin nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

7. E drejta e informimit e parashikuar në ligjin nr.119/2014 "Mbi të drejtën e informimit mbi dokumentet publike" mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të dukshëm dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit.

KREU II

KRIJIMI I INSTITUCIONEVE TË RIVLERËSIMIT. KRITERET DHE PROCEDURAT

Neni 5

1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë.

2. Kolegji i Apelimit gjykon ankimet ndaj vendimeve të Komisionit. Në përputhje me ligjin nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Apelimit gjatë mandatit 9 vjeçarë," ka të drejtë të shqyrtojë:

a. shkeljet disiplinore ndaj anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

b. ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe Inspektoriatit të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore.

Neni 6

Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve

1. Anëtar i Komisionit dhe Kolegjit të Apelimit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson kriteret e mëposhtme:

- (a) ka përfunduar studimet në drejtësi, në nivelin e dytë të studimeve ose studime të barasvlershme me to, brenda ose jashtë vendit;
- b) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një aktivitet të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të ketë marrë një vlerësim të lartë për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral, nëse i është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme.
- ç) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit;
- d) ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, apo ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit në momentin e aplikimit;
- f) të ketë kaluar me sukses kontrollin e deklaramit të pasurisë së tij, ose të personave të lidhur me të;
- g) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990 dhe nuk ka qenë bashkëpunëtor, informant ose agjent i ndonjë shërbimi sekret.⁵
- gj) zotëron shumë mirë gjuhën angleze;

2. Përmbushja e kriterëve të mësipërme vlerësohet, në veçanti, bazuar në:

- a) titujt shkencorë në fushën e së drejtës;
- b) eksperiencën e veçantë të kandidatit në sfera të caktuara të së drejtës;
- c) vjetërsinë në profesion;
- ç) përvojën profesionale jashtë shtetit;
- d) notën mesatare jo më pak se 8, nëse ka përfunduar studimet brenda vendit;

3. Kërkesat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni zbatohen edhe për zgjedhjen e Komisionerit Publik, me përjashtim të kriterit të eksperiencës në punë, i cili nuk duhet të jetë më pak se 10 vite në profesion.

⁵Detyrim që rrjedh nga Ligji 45/2015 'Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 7

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve

1. Avokati i Popullit shpall vendet vakante për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve brenda njëzet ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në faqen zyrtare të internetit, si dhe në dy gazeta me tirazhin më të lartë në vend.
 2. Personat e interesuar mund të aplikojnë brenda njëzet ditëve nga publikimi i vendeve vakante. Kërkesa regjistrohet në regjistrin e protokollit të Avokatit të Popullit. Aplikuesi pajiset me një dokument që vërteton numrin e aplikimit, datën dhe listën e dokumenteve të paraqitura.
 3. Në kërkesën që paraqet, aplikuesi mund të parashtrorë vendin vakant për të cilin është i interesuar të aplikojë. Në rast se aplikuesi nuk ka parashtruar asnjë preferencë për vendin vakant, konsiderohet që ai aplikon për të gjithë vendet vakante. Bashkëlidhur me kërkesën, aplikuesi dorëzon 2 (dy) kopje të dokumenteve të mëposhtme:
 - a) curriculum vitae (jetëshkrim) duke përfshirë të dhënat e kontaktit, posten elektronike zyrtare dhe adresën postare;
 - b) kopje të noterizuara të diplomës ose të njehsuara nga institucioni;
 - c) kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njehsuara nga institucioni, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji;
 - d) formularin e depozituar të deklaramit të pasurive për aplikuesin dhe personat e lidhur të tij;
 - e) Një dokument të nënshkruar prej tij me të cilin aplikuesi pranon kufizimet e posaçme për fshehtësinë në telekomunikime gjate kohëzgjatjes së mandatit si anëtar i institucioneve, sipas Shtojcës ___ të këtij ligji.
 4. Avokati i Popullit, brenda 5 ditëve nga dita e mbarimit të afatit të aplikimit, duhet të përcjellë listën e emrave të aplikuesve, së bashku me një kopje të dokumenteve shoqëruese, tek Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit.
 5. Avokati i Popullit, verifikon aplikimet në lidhje me plotësimin e kriterëve formale dhe njofton brenda njëzet ditëve aplikuesit, nëpërmjet postës elektronike nëse:
 - a) kanë plotësuar kriteret formale, ose
 - b) nuk i kanë plotësuar kriteret formale,
- Për rastet kur kriteret formale nuk janë plotësuar, Avokati i Popullit i bën me dije aplikuesit që të plotësojë mangësitë brenda 10 ditëve nga dita e njoftimit.
6. Avokati i Popullit brenda 20 ditëve njofton aplikuesit që nuk plotësojnë haptazi kriteret formale. Në këtë rast, aplikuesi ka të drejtën e ankimit. Avokati i Popullit shqyrton ankimin brenda 5 ditëve pasi është këshilluar paraprakisht me vëzhguesit ndërkombëtarë.
 7. Lista e aplikuesve e hartuar pas përfundimit të procesit të parashikuar në pikat 5 dhe 6 të këtij neni, i dërgohet ILDKPKI-së, dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
 8. ILDPKI me përparësi dhe jo më vonë se 90 ditë nga marrja e kërkesës, kryen një kontroll të plotë të deklaratave të aplikuesve dhe përpilon një raport të detajuar mbi saktësinë e të dhënave për çdo aplikues, të cilin ia dërgon menjëherë Avokatit të Popullit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
 9. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit pasi verifikon listën dhe raportin e ILDPKI-së, mund të fshijë emrat në listën e aplikanteve me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë në procesin

e përzgjedhjes. Lista e përditësuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i dërgohet Avokatit të Popullit.

10. Avokati i Popullit ia përcjell menjëherë listën e përditësuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Zgjedhja e kandidatëve nga Kuvendi

1. Komisioni parlamentar që mbulon çështjet ligjore, shqyrton dhe vendos për rekomandimet e dhëna nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, dhe miraton listën e konsoliduar /tërësore të aplikuesve brenda 5 ditëve nga depozitimi i saj.

2. 1/5 e deputeteve, brenda 5 ditëve, ka të drejtë të kërkojë votimin e rrezimin e listës konsoliduar/tërësore në seancë plenare. Kuvendi, voton në seancën e radhës me 2/3 e anëtarëve të tij.

3. Në rast se Kuvendi rrëzon listën e konsoliduar sipas paragrafit të mësipërm, procesi i rivlerësimit përfundon pa sukses.

Neni 9

Votimi i kandidatëve në seancë plenare

1. Votimi i kandidateve behet brenda 30 ditëve nga miratimi i listës së konsoliduar/tërësore. Për zgjedhjen e kandidatëve, Kuvendi zhvillon deri në tre votime. Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga miratimi i listës së konsoliduar. Secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës.

2. Anëtarët e Kuvendit perzgjedhin në listën e konsoliduar, kandidatët për secilin vend vakant dhe 5 (pesë) kandidatë zevendesues.

3. Kandidati fitues është ai që ka marrë jo më pak se dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

4. Në rast se edhe pas votimit të tretë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar dhe numri i vendeve vakante është i paplotësuar, zgjedhja bëhet nëpërmjet shortit manual publik të organizuar nga Presidenti i Republikës.

Neni 10

Shorti

1. Shorti për plotësimin e vendeve vakante hidhet nga lista e konsoliduar/tërësore e parashikuar në nenin 8 paragrafi 1 i këtij ligji.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Sekretari i Përgjithshëm i Avokatit të Popullit dhe përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit ftohen për të tërhequr shortin.

3. Të gjithë të pranishmit ftohen të nënshkruajnë procesverbalin, i cili pasqyron procedurën e shortit.

4. Kandidatët e zgjedhur me short dekretohen nga Presidenti i Republikës brenda 3 ditëve.

KREU III

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË RIVLERËSIMIT

Neni 11

Organizimi i brendshëm i institucioneve

1. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit organizohen në trupa gjykuese. Trupi gjykues përbëhet nga 3 anëtarë dhe kryesohet nga Kryetari, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të tjerë për një periudhë -vjeçare pa të drejtë rizgjedhje. Shpërndarja e çështjeve në trupa gjykyese behër nëpërmjet shortit. Lista e komisionereve dhe gjyqtarët që plotësojnë trupat gjykues caktohet me short.
2. Mbledhja e parë e trupit gjykues të Komisionit dhe Kolegjit të Apelimit drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë. Trupi gjykues, në respektim të parimit të rotacionit bie dakord së cili nga anëtarët do të jetë kryetar përkatësisht, për çdo vit në vijim. Në rast se nuk arrihet dakordësia, anëtari më i vjetër në moshë vendos për radhën e kryesimit.
3. Detyrat e Kryetarit janë:
 - a) të caktojë nëpërmjet shortitrelatorin për çdo çështje, duke respektuar parimin e barazisë për të gjithë anëtarët e trupit gjykues;
 - b) të thërrasë dhe të kryesojë mbledhjet dhe seancat dëgjimore;
 - c) të bashkërendojë punën dhe të marrë masa për të garantuar zbardhjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm.
4. Një anëtar i trupit gjykues do të jetë relatori.
5. Relatori i çështjes ka këto detyra:
 - a) të përgatisë dosjen që diskutohet nga trupi gjykues;
 - b) të ndërmarrë të gjitha procedurat për të garantuar provat e nevojshme për procesin e vendim-marrjes së trupës gjykuese.
 - c) të marrë të gjitha masat për të hartuar dokumentacionin e nevojshëm deri në përfundimin e çështjes.
 - d) të kërkojë informacion shtesë në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
 - e) propozon marrjen e një vendimi duke parashtruar arsyetimin.

Neni 12

Mbarimi i mandatit i anëtarëve

1. Mandati i komisionerit, gjyqtarit dhe komisionerit publik mbaron para kohe, sipas rasteve të parashikuara në Kushtetutë.
2. Në rast se vendi i komisionerit, gjyqtarit apo komisionerit publik, mbetet vakant dhe është në pamundësi për tu plotësuar nga kandidatët zëvendësues, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit ose i Kolegjit të Apelimit njofton me shkrim Kuvendin brenda 6 ditëve. Procedura për zëvendësimin kryhet sipas rregullave të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji.

Neni 13

Rastet dhe procedurat për shkarkimin e anëtarëve

1. Në rast se ka të dhëna të mjaftueshme nga burime të besueshme se anëtari i institucioneve ka kryer një shkelje disiplinore, ndaj tij fillon hetimi disiplinor. Subjektet që mund të kërkojnë fillimin e hetimit disiplinor janë:

- a) çdo komisioner për komisionerët;
- b) çdo gjyqtar për gjyqtarët e Kolegjit të Apelistit;
- c) çdo vëzhgues ndërkombëtar për Komisionerin Publik, Komisionerin dhe gjyqtarin e Kolegjit të Apelistit.

2. Kërkesa për fillimin e hetimit disiplinor bëhet me shkrim tek Sekretari i Përgjithshëm i Komisionerit ose Kolegjit të Apelistit, sipas rastit. Raportimi mbi shkeljet disiplinore nga publiku paraqiten pranë vëzhguesit ndërkombëtar.

3. Procedura hetimore disiplinore duhet të fillojë pa vonesë të arsyeshme nga konstatimi i shkeljes disiplinore. Në rast se anëtari i institucionit jep dorëheqjen nga detyra, procedura hetimore mbyllet pa një vendim përfundimtar.

4. Komisioni Disiplinor përbëhet nga 3 gjyqtarë të Kolegjit të Apelistit të zgjedhur me short, rast pas rasti, pa pjesëmarrjen e anëtarit që i nënshtrohet procedimit disiplinor sipas ligjit. Gjyqtari hetues zgjidhet me short ndërmjet të gjithë anëtarëve të Kolegjit të Apelistit, pa pjesëmarrjen e anëtarit që i nënshtrohet procedimit disiplinor. Shorti organizohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Apelistit.

5. Gjyqtari hetues harton një raport mbi rezultatet e hetimit për shkeljen disiplinore dhe ia dërgon menjëherë për shqyrtim Komisionit Disiplinor.

6. Komisioni Disiplinor, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së raportit, vendos si më poshtë:

- a) caktimin e një mase disiplinore në përputhje me Ligjin për Statusin;
- b) caktimin e një mase disiplinore dhe dërgimin e çështjes, sipas rastit, në Zyrën Prokurorisë së Përgjithshme ose SPAK, nëse konstaton që shkelja disiplinore përbën edhe një vepër penale.
- c) mosdhënien e masës disiplinore, nëse konstaton se nuk ka shkaqe për një masë të tillë.

7. Anëtari i institucionit që i nënshtrohet procedimit disiplinor ka të drejtë të informohet, mbrohet dhe dëgjohet gjatë procedimit disiplinor. Komisioni Disiplinor në ushtrimin e funksioneve të tij respekton në mënyrë të balancuar parimin e pavarësisë, paanësisë dhe besueshmërisë, si dhe të drejtën për respektimin e jetës private. Ligji për statusin mund të zbatohet për aq sa është e mundur.

Neni 14

Organizimi dhe administrata e institucioneve

1. Institucionet kanë personelin dhe pajisjet e nevojshme për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga ky ligj. Struktura organizative dhe klasifikimi i pagave për punonjësit e institucioneve përcaktohen sipas Shtojcës_ të këtij ligji.

2. Kolegji i Apelistit ndihmohet edhe nga strukturat mbështetëse të Gjykatës Kushtetuese.

3. Marrëdhënia e punësimit me punonjësit e institucioneve rregullohet sipas këtij ligji dhe Kodit të Punës.

4. Autoriteti përgjegjës për rekrutimin e punonjësve të institucioneve është *komiteti ad hoc* që krijohet pranë cdo institucioni. Komiteti ad hoc përbehet nga kryetaret e trupave gjykesive të Komisionit ose Kolegjit të Apelit, si dhe Komisioneri Publik më i vjetër në moshë. Për komisionerin publik përberja e komiteti ad hoc do të jetë nga 2 komisionerët publik dhe nga gjyqtari më i vjetër në moshë i Kolegjit Apelit.

Neni 15 **Sekretari i Përgjithshëm**

1. Jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Avokati i Popullit publikon vendet vakante për dy Sekretarët e Përgjithshëm në faqen zyrtare të tij të internetit dhe në 2 (dy) gazetat me tirazhin më të lartë në vend. Personat e interesuar aplikojnë për këto vende brenda 20 ditëve pas publikimit. Avokati i Popullit përgatit dosjet dhe ia përcjell institucioneve përkatëse, pasi ato të kenë filluar së funksionuari.

2. Procesi i rekrutimit bazohet në një procedurë të hapur dhe transparente për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga komiteti ad hoc i krijuar në institucionin përkatës.

3. Sekretari i Përgjithshëm mund të jetë shtetasi shqiptar, i cili plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) ka përfunduar studimet në drejtësi ose shkencë ekonomike;
- b) ka pasur një eksperiencë pune në nivel menaxherial dhe drejtues, jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
- c) ndaj tij të mos të ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ç) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;
- d) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, apo ndonjë masë tjetër disiplinore e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- e) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit;

4. Pas mbarimit të afatit të aplikimit, Komiteti *ad hoc* vendos për zgjedhjen e kandidatit bazuar mbi dokumentet e paraqitura.

6. Detyrat e sekretarit të përgjithshëm janë:

- a) të përfaqësojë institucionin në lidhje me palët e treta;
- b) të administrojë regjistrin e dosjeve;
- c) të organizojë dhe të drejtojë punën e përditshme të të gjithë personelit me përjashtim të personelit këshillimor;
- d) të trajtojë çështjet në lidhje me marrëdhëniet me publikun;
- f) të organizojë punën për përgatitjen e raportit vjetor për shpenzimet financiare;
- g) të rekrutojë personelin administrativ sipas Kodit të Punës.

Neni 16

Njësia e Shërbimit Ligjor

1. Pranë Komisionit, dhe Kolegjit të Apelimit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor që ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të institucioneve. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë të cilët emërohen sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në Shtojcën _ të këtij ligji. Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të mbledhjes së komisionereve ose gjyqtarëve.

2. Detyrat e këshilltarit ligjor janë:

- a) analizimi/studimi i dosjes
- b) kryerja e detyrave të tjera të caktuara nga relatori i çështjes.

3. Detyrat e këshilltarit ekonomik janë:

- a) analizimi/studimi i dosjes nga pikëpamja financiare/ekonomike dhe përgatitja e relacionit të çështjes, veçanërisht për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit;
- b) kryerja e detyrave të tjera të caktuara nga relatori i çështjes.

Neni 17

Marrëdhëniet me median

Institucionet kanë punonjës përgjegjës për marrëdhëniet me median, i cili është ndërmjetës midis trupave gjykues dhe medias vendase e ndërkombëtare.

Neni 18

Mbrojtja e anëtarëve të institucioneve dhe personelit vendas dhe ndërkombëtar

1. Në rast se jeta, shëndeti ose prona e anëtarëve të institucioneve dhe personave të lidhur me to është në rrezik, shteti ofron mbrojtje sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e veçantë për të gjithë gjyqtarët.

2. Personeli i Komisionit dhe i Kolegjit të Apelimit, si dhe personeli mbështetës i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit gëzojnë të drejtën e mbrojtjes, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e veçantë për të gjithë gjyqtarët.

Neni 19

Deklarimi i pasurisë nga anëtarët e institucioneve

Komisionerët, gjyqtarët, komisionerët publikë, sekretari i përgjithshëm dhe këshilltarët ekonomikë dhe ligjorë, si dhe personat e lidhur me to, paraqesin një deklaratë periodike vjetore të pasurive gjatë kohëzgjatjes së mandatit, deri tre vjet pas përfundimit të tij, në përputhje me ligjin nr.9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. ILDKPKI, çdo vit, zhvillon një kontroll të plotë të deklaratave.

Neni 20

Garantimi i paanësisë

1. Komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë deklarojnë dhe shmangin çdo situatë konflikti interesi, në respektim të ligjit nr.9367/2005 “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit”. Çdo vendim i marrë në një situatë konflikti interesi, përveç pasojave ligjore, përbën shkelje disiplinore sipas këtij ligji.⁶
2. Në rast se një anëtar i institucioneve nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkaqet e përmendura në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit nr 9367, /2005 “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, ai duhet të njoftojë me shkrim menjëherë trupin gjykues. Përfundimi i komisionerit, gjyqtarit ose komisionerit Publik nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trup gjykues që caktohet me short.
3. Çdo person i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me short.

Neni 21

Kushtet për garantimin e besueshmërisë dhe konfidencialitetit

1. Telekomunikimi i anëtarëve të institucioneve monitorohet nga Shërbimi Informativ Shtetëror,⁷ kurse të dhënat/treguesit e tyre financiarë monitorohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave sipas pëlqimit të dhënë prej tyre në nenin 7, paragrafi 3, germa e) e këtij ligji, për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre.
2. Komisionerët, gjyqtarët, komisionerët Publikë dhe personeli i këtyre institucioneve trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit në respektim të parimit e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Institucionet përjashtohen nga ky detyrim vetëm në rastet kur informacioni i jepet subjektit të rivlerësimit, ose organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës zyrtare.

Neni 22

Paga e anëtarëve të institucioneve

1. Anëtari i institucioneve ushtron detyrën me kohë të plotë.
2. Komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët Publikë marrin një pagë bruto sipas dispozitave të Ligjit për Statusin dhe Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Ata përfitojnë një pagesë mujore shtesë për shkak të vështirësisë, në vlerën e 100 000 (njëqind mijë) ALL.

⁶Kjo është një shkelje e rreme disiplinore e parashikuar në këtë ligj; të jene në përputhje me ligjin për statusin për arsye të tjera.

⁷Formulim alternativ: Byroja Kombetare e Hetimit kryen monitorimin.

3. Anëtarët e institucioneve përfitojnë një pension suplementar, për çdo vit të ushtrimit të detyrës, në vlerën 2% të pagës vjetore. Kur periudha është më e shkurtër se një vit, pensioni llogaritet, rast pas rasti. Pensioni paguhet çdo muaj pas përfundimit të mandatit deri në fund të jetës së anëtarit.

KREU IV VLERËSIMI I PASURISË

Neni 23

Objekti i vlerësimit të pasurisë

Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, duke përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Neni 24

Fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë

1. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë deklaratën e pasurisë sipas Shtojcës ___ bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgojnë pranë ILDPKI-së.
2. ILDPKI fillon menjëherë procedurën e kontrollit në përputhje me nenin 4, paragrafi 4, i këtij ligji.
3. Subjektet e rivlerësimit sipas nenit 179/b paragrafi 4, fjalia e dytë, kanë të drejtë të paraqesin një kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit, me qëllim rivlerësimin brenda 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kërkesa i bashkëlidhet deklaratës së pasurisë, sipas Shtojcës së këtij ligji.

Neni 25

Deklarimi i pasurisë

1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.
2. Nëse subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur kanë pasuri jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ai paraqet deklaratimet bankare të viteve të fundit, të dhënat e fundit mbi regjistrimin e pasurisë ose dokumente të tjera që tregojnë vlerën e pasurive që ndodhen jashtë shtetit.

3. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, apo persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.
4. Deklarimet e interesave private dhe pasurore të paraqitura më parë te ILDPKI mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

Neni 26

Procedura e vlerësimit të pasurive

1. ILDPKI, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin nr. 9049/2003 “Mbi deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, dhe Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.
2. Inspektori i Përgjithshëm i ILDPKI-t, për qëllimet e rivlerësimit, mund të kërkojë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ose Ministrisë së Drejtësisë dokumentet për pasuritë në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me ta, ose dokumentet që përdoren jashtë shtetit nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, ose të dhënat financiare mbi çdo transaksion financiar brenda ose jashtë vendit sipas ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta. Këto dokumente ose informacione mund të përdoren në cilësinë e provave përpara Komisionit ose Kolegjit të Apelit.
3. ILDPKI mundëson akses të plotë për vëzhguesit ndërkombëtarë, të cilët me kërkesën e tyre, kanë të drejtë të konsultojnë, kopjojnë ose hetojnë deklaratimet e pasurive të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ose personat e lidhur me të, si dhe dokumentet shoqëruese.
4. ILDPKI kryen një procedurë të plotë kontrolli brenda afatit prej 180 ditësh, në përputhje me nenet 4, paragrafi 4, i këtij Ligji.
5. Me përfundimin e kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDPKI-t përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar dhe sipas rastit, konstaton se:
 - a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi;
 - b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) është kryer fshehje e pasurisë;
 - d) është kryer deklarim i rremë;
 - e) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

KREU V

KONTROLLI I FIGURËS

Neni 27

Objekti i kontrollit të figurës

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Neni 28

Fillimi i procedurës për kontrollin e figurës

1. Subjektet e rivlerësimit plotësojnë formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, sipas Shtojcës bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgojnë atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.
2. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar fillon menjëherë procedurën e kontrollit të figurës, në përputhje me nenin 4, paragrafi 4, i këtij ligji.
3. Subjektet e rivlerësimit sipas nenit 179/b paragrafi 4, fjalia e dytë, kanë të drejtë të paraqesin një kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit, me qëllim kontrollin e figurës, brenda 180 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kërkesa i bashkëlidhet formularit për deklaramin e kontrollit të figurës, sipas Shtojcës___ të këtij ligji.

Neni 29

Struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës

1. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar është autoriteti përgjegjës për kontrollin e Figurës, në bashkëpunim me Komisionin dhe Kolegjin e Apelit. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar ka të drejtë të caktojë një personel shtesë, për të kryer kontrollin e Figurës sipas qëllimit të këtij ligji. Personat që kryejnë kontrollin e figurës karakterizohen nga sjellje shembullore etike dhe profesionale, si dhe përmbushin standardet e zbatueshme për mbrojtjen e privatësisë dhe të konfidencialitetit në detyrë.
2. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, krijojnë një grup pune për kryerjen e detyrave sipas këtij ligji. Këto struktura mund të caktojnë personel për të mbështetur grupin e punës për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit.
3. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe grupi i punës/task forcë kanë të drejtë të komunikojnë me shtetet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e përfshirë në krimin e organizuar ose për personat e dyshuar të krimin të organizuar për qëllim të këtij ligji.

Neni 30

Detyrat e grupit të punës

Grupi i punës, gjatë procedurave të verifikimit të sigurisë, duhet t'iu përmbahet kërkesave të përgjithshme të kontrollit të figurës, si më poshtë:

1. verifikimi i saktë i identitetit, gjeneraliteteve dhe statusit të shtetësisë, në të shkuarën dhe të tashmen, për çdo individ;
2. kontrolli i rekordeve në nivel lokal e kombëtar, në funksion të aktivitetit dhe tendencave kriminale;
3. vlerësimi i përgjithshëm, nëse individit mund të vihet nën presion nga struktura kriminale ;
4. Kontrolli nëse ka qenë, është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale;
5. Verifikimi nëse rezulton i dënuar për një ose më shumë vepra penale, ka sjellje të keqe, tendenca kriminale e përfshirje në krimin e organizuar;

Neni 31

Standardet e Kontrollit e Figurës

1. Kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, si dhe në informacione konfidenciale dhe informacione të tjera të disponueshme.
2. Kontrolli i figurës, kryhet në mënyrë objektive pa ndikime të karakterit personal, armiqësore dhe miqësore, të cilat mund të favorizojnë apo disfavorizojnë subjektin e rivlerësimit.
3. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur:
 - a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
 - b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një telefonatë me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
 - c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri, me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
 - ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
 - d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në disa takime, aktivitete, vakte ose raste të tjera, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e skeduar në regjistrat përkatës.
4. Rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar janë kur :
 - a) subjekti i rivlerësimit në mënyrë të besueshme parashtron se nuk është në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara sipas nënparagrafit a.
 - b) Marrëdhënia familjare e subjekti të rivlerësimit me personin e përfshirë në krimin e organizuar është e largët, ose ka kontakte familjare të rralla.
 - c) Subjekti i rivlerësimit ka qenë i hapur, i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet dhe është distancuar prej tyre. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me kohëzgjatjen

e kontakteve ose me perceptimin e arsyeve të veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit.

c) subjekti i rivlerësimit i ka qenë në dijeni që personi është i përfshirë në krimin e organizuar, por nuk ka qenë në dijeni të faktit se, ai do të ishte i pranishëm në një takim, vakt apo është mashtruar për një takim të tillë. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me rrethanat e parashikuara në nënparagrafin a).

d) kontaktet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë pesë vjet më parë dhe nuk ka ndonjë tregues që ato vazhdojnë ende. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontakteve dhe/ose me rrethanat e parashikuara në nënparagrafin a).

5. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm janë kur:

a) Subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga provat paraprake të besueshme.

b) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt, i cili përforcohet ose konsiderohet i besueshëm nga informacione të shërbimeve të fshehta dhe të besueshme.

c) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që konstatohet nga informacioni përkatës i besueshëm dhe nga prova të tjera; në rast se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të tjera që janë renditur ose konstatuar sipas nënparagrafit a; në rast se ka prova të tjera për një përfitim, veprim ose pasojë nga kontakti që krijon një dyshim të arsyeshëm se, informacioni i marrë është shpjegimi i vetëm i mundshëm.

6. Rrethanat lehtësuese që merren parasysh në konstatimin sipas të cilit formulari i deklarimit nuk është përfunduar plotësisht dhe me besueshmëri janë :

a) subjekti i rivlerësimit rendit në listë një kontakt, por data ose vendndodhja nuk është e saktë dhe kjo duket se është thjesht gabim ose ngatërresë.

b) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt, por ka qenë i besueshëm dhe i plotë në lidhje me kontaktet e tjera dhe kjo mospërfshirje është thjesht gabim ose ngatërresë.

c) kontakti ka ndodhur në një vend me shumë njerëz dhe është e besueshëm fakti se, kontakti nuk mund të mbahej mend ose mund të mendohej i parëndësishëm. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontaktit ose me faktorë të tjerë sipas këtij paragrafi.

7. Subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që ka të bëjnë kryesisht, me një anëtar të familjes dhe rrethanat e atij kontakti nuk mund të mbaheshin mend ose nuk ishin të rëndësishme. Kjo rrethanë mund të vlerësohet në raport me shkallën e seriozitetit të kontaktit ose me faktorë të tjerë sipas këtij paragrafi.

Neni 32

Procedura për kontrollin e figurës

1. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar brenda 60 ditëve nga marrja e formularit, verifikon nëse informacioni është i saktë dhe nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në përfundim të afatit 60-ditor, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të

Klasifikuar mund t'i kërkojë Komisionit një zgjatje 30-ditore të afatit të verifikimit, në rast se është kërkuar informacion nga shtete të tjera.

2. Brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit dhe i verifikimit, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar i paraqet Komisionit:

(a) Një dokument/raport publik që përcakton nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, plotësisht dhe me vërtetësi; nëse ka informacion në deklaramin e tij ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe një konstatim në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës. Ky dokument përmban informacion mbi kontaktet dhe kushtet e parashikuara në nenin 31, paragrafi 3, të këtij ligji. Informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër.

b) një dokument i klasifikuar që jep informacione shtesë në mbështetje të dokumentit publik të parashikuar në paragrafin 2 (a).

3. Institucionet kanë detyrimin të respektojnë legjislacionin mbi trajtimin e dokumenteve të klasifikuara.

KREU VI VLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

Neni 33

Objekti i vlerësimit të aftësisë profesionale

Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për statusin.

Neni 34

Fillimi i procedurës për vlerësimin e aftësisë profesionale

1. Procedura e vlerësimit të aftësisë profesionale për të gjithë subjektet e rivlerësimit fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale për efekt të këtij ligji do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periudha vlerësimit do të konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës.

3. Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janar 2006 e në vazhdim, në rast se informacioni për etikën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit parashtrohet sipas nenit 46 të këtij ligji. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve mund të marrë parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes apo vëzhguesi ndërkombëtar, i çmon si të nevojshme për procesin e rivlerësimit.

Neni 35

Burimet për rivlerësimin e aftësisë profesionale

1. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në Ligjin për Statusin. Prokurori i

Përgjithshëm vlerësohet bazuar në përmbushjen e detyrave të parashikuara në nenin 8 të ligjit nr. 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për një periudhë 3 vjeçare nga fillimi i mandatit.

2. Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen sipas këtyre burimeve:

a) nga relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura për çështjet e gjyqësore,

b) rezultatet e provimit të pranimit në Shkollën e Magjistraturës. Subjekti i vlerësimit që merr më pak se 60 % të pikëve të provimit, ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën pranë Komisionit.

3. Inspektori rivlerësohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 36, datë 29.04.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të këshillit të lartë të drejtësisë”.

4. Ish-gjyqtari dhe ish-prokurori vlerësohen bazuar në burimet e mëposhtme:

a) 5 dokumente ligjore të përpiluara prej tij gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës.

b) raportet e vlerësimit të aftësive profesionale gjatë kohës që ka punuar.

5. Në rast se për ish gjyqtarin ose ish prokurorin, nuk ka raporte vlerësimi për aftësitë e tij profesionale, ai duhet t’i nënshtrohet provimit të pranimit pranë Shkollës së Magjistraturës sipas paragrafit 2, germa b e këtij neni dhe dispozitave të ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 36

Procedura për vlerësimin e aftësisë profesionale

1. Procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me Ligjin për Statusin, për aq sa është i zbatueshëm.

2. Inspektorët rishikojnë dokumentet ligjore të hartuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit dhe, bazuar në gjetjet, ata përgatisin një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Ky raport i paraqitet Komisionit, menjëherë.

3. Subjekti i rivlerësimit dhe institucionet përkatëse duhet të garantojnë pajisjen e institucioneve të rivlerësimit me dokumentet e nevojshme. Nëse institucionet e rivlerësimit nuk marrin dokumentet e kërkuara për shkak të mungesës së bashkëpunimit me subjektin e rivlerësimit, ose me institucionet përkatëse, relatori i njofton ata për pasojat e mosbashkëpunimit, duke u dhënë një afat prej 5 ditësh, për të plotësuar kërkesën. Në rast mosbashkëpunimi, subjektit të rivlerësimit mund t’i jepet një vlerësim i papërshtatshëm.

4. Nëse organet e rivlerësimit të aftësive profesionale ose Relatori nuk marrin dokumentet e nevojshme, ato njoftojnë Komisionin se ndodhen në kushtet e pamundësisë për të zhvilluar vlerësimin dhe propozojnë një vlerësim “të papërshtatshëm” për subjektin e rivlerësimit. Nëse relatori, vihet në dijeni nga shtetasit/publiku ose burime të tjera në përputhje me nenin 46 të këtij ligji mbi faktet të besueshme për punën e subjektit të rivlerësimit, ai mund të vazhdojë procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

5. Në raste të veçanta, kur informacioni është i ndërlikuar ose i vështirë për t’u marrë, relatori mund të kërkojë zgjatje të afatit të rivlerësimit nga Komisioni.

Neni 37

Raporti i rivlerësimit

Relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit të parashikuara në Ligjin për Statusin e Gjyqtarëve dhe akteve e tjera ligjore. Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë:

- a) “I aftë”: kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.
- b) “Me mangësi”: kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv. Komisioni ka rekomanduar program trajnimi të destinuar për t’u riparuar këto mangësi brenda një viti;
- c) “I papërshtatshëm”: kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit të Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

KREUVII

PROCEDURA E RIVLERESIMIT

Neni 38

Parimet

1. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit.
2. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, Kolegji i Apelit dhe vëzhguesi ndërkombëtar mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike sipas nenit 41 dhe 42 të këtij ligji. Komisioni, Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit.

Neni 39

Njoftimi

1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike zyrtare të subjekteve të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë të parashikuar në nenin 28, paragrafi 2, i këtij ligji.
2. Nëse subjekti i rivlerësimit është me leje të zakonshme ose me leje lindjeje, njoftimi bëhet në adresën elektronike private që është dhënë në deklaratën e pasurisë të parashikuar në nenin 28 paragrafi 2 të këtij ligji.
3. Në rastin subjekteve të rivlerësimit sipas nenit 179/b paragrafi 4, fjalia e dytë të Kushtetutës, njoftimi dhe çdo komunikim tjetër gjatë procesit të rivlerësimit, bëhet në adresën elektronike të dhënë prej tyre.

4. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren format e tjera të komunikimit sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 40

Të drejtat e subjektit të rivlerësimit

Të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas neneve 35 – 40 dhe neneve 45 – 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 41

Bashkëpunimi gjatë procesit të hetimit

Subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit. Komisioni ose Kolegji i Apelimit, në marrjen e vendimit mban parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar gjatë procesit.

Neni 42

Mjetet për kërkimin e provës

1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelimit mund:

- a) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët dhe ekspertët;
- b) të marrë dokumente shkresore dhe dokumente të tjera nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
- c) të vizitojë dhe të kontrollojë sende të luajtshme ose të paluajtshme bazuar në vendimin e gjykatës kompetente.

2. Deklarata e dhënë nga dëshmitari apo eksperti gjatë një procesi penal mund të përdoret në cilësinë e provës. .

3. Faktet e njohura për Komisionin ose faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji, nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

4. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit nuk mund ta bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burimet e panjohura, në prova që nuk janë të besueshme ose janë në papajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ato kanë të drejtë të çmojnë sipas bindjes së tyre të brendshme, indiciet në tërësi, të lidhura me rrethanat e çështjes.

5. Dokumentet dhe të dhënat e marra nga burimet e shteteve të huaja në përputhje me këtë ligj, vlerësohen nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.

6. Gjetja e paraqitur në formën e deklaratës, dokumentit apo raportit të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë thelbësore që provon se, një fakt, rrethanë apo standard ligjor ekziston ose ka ndodhur. Gjetja hartohet në mënyrë të hollësishme duke paraqitur rrethanat për konstatimin e bërë. Nëse gjetja është e përpiluar në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit çmohet si e barasvlefshme me mendimin e dhënë nga një ekspert

7. Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë konsiderohet një konkluzion i dhënë për një rrethanë konkrete gjatë procesit të rivlerësimit ose që rezulton nga faktet në çështje të veçanta. Mendimi mund të ndikojë në vendimmarrjen e Komisionit apo Kolegjit të Apelimit,

por nuk ka vlerën e provës. Në rast se Komisioni ose Kolegji i Apelimit ka mendim të kundërt me gjetjen e parashtruar nga vëzhguesit ndërkombëtarë, arsyeton me vendim shkaqet e refuzimit.

8. Në rast se Komisioni ose Kolegji i Apelimit vendos të mos marrë në konsideratë kërkesën e vëzhguesit ndërkombëtar për të marrë prova, arsyeton me vendim shkaqet e refuzimit.

Neni 43

Akresi në informacion

1. Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë bashkëpunojnë me organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendase ose të huaja, për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit.
2. Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të plotë në të gjitha të dhënat, pranë SPAK-ut si dhe në të dhënat që vijojnë:
 - a) në dosjet personale të subjekteve të rivlerësimit, të dhënat statistikore, dosjet e zgjedhura për vlerësim, vetë-vlerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat mbi trajnimet, mbi ankesat ndaj personave që i nënshtrohen vlerësimit dhe rezultatet e verifikimit ankesave, si dhe mbi vendimet për masat disiplinore ndaj të vlerësuarve;
 - b) në të dhënat mbi pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme, ose të përfituara nga një akt noterial i paregjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për këtë qëllim, Komisioni ose Kolegji i Apelimit ka të drejtë të kërkojë informacion nga regjistri i pasurive të paluajtshme, ose nga regjistri noterial shqiptar;
 - c) në llogaritë bankare, të dhënat tatimore, bazat e të dhënave mbi automjetet, të dhënat për hyrje–daljet në kufi;
 - d) në të dhënat mbi të drejta apo interesa pasurore të çdo lloji mbi një aset, qoftë ky i luajshëm ose i paluajshëm, i trupëzuar ose i patrupëzuar, material ose jomaterial, përfshirë dhe ato të evidentuara në formë elektronike apo numerike, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në instrumente të tilla si kreditë, çeqet e udhëtimit, çeqet bankare, urdhërpagesat, të gjitha llojet e titujve, mandatpagesat dhe letrat e kreditit, si dhe çdo interes, dividend, e ardhur apo vlerë tjetër që buron prej tyre;
 - e) në të dhënat mbi marrëdhënie të mundshme biznesi, veprimtari tregtare ose veprimtari të tjera profesionale;
 - f) në të dhënat që provojnë ekzistencën e parave fizike ose mjeteve apo instrumenteve të tjera të tregut të parasë dhe/ose të pagesave, ku përfshihen por pa u shteruar, çeqet, dëftesat, certifikatat e depozitave, kartat e debitit ose të kreditit, kartat elektronike të pagesave, titujt, si dhe çdo dokument tjetër që vërteton ekzistencën e një detyrimi monetar ose një vlere tjetër të depozituar ose për t'i paguar subjektit një shumë korresponduese në para fizike, ose në një formë tjetër;
 - g) Të dhënat që provojnë ekzistencën e trusteve⁸ ose marrëveshjeve të tjera të ngjashme.

⁸Trust' është një marrëveshje mirëbesimi, ku pronësia mbahet nga i mirëbesuari për llogari të përfituesit. Sipas nenit 2/19 I ligjit nr.9917/2008

3. Nëse të dhënat dhe informacioni mbi çështjet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, ruhen dhe administrohen në formë elektronike, apo përpunimi dhe përditësimi i tyre kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, institucioni publik ose personi juridik privat që ushtron funksion publik, kanë detyrimin të pajisin Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit me kodet hyrëse të nevojshme për aksesimin e plotë të informacionit të nevojshëm për verifikim. Niveli i aksesimit për secilin rast, bëhet nëpërmjet niveleve të sigurisë të përcaktuara në varësi të funksionit dhe nevojës për informacion të Komisionit dhe Kolegjit të Apelimit.

4. Me kërkesë të Komisionit ose Kolegjit të Apelimeve, bankat e nivelit të dytë dhe subjektet e tjera që ushtrojnë aktivitete bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë janë të detyruara të japin informacion mbi depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga subjekti i rivlerësimit apo personat e lidhur më të. Institucionet private rimbursohen për çdo kërkesë, duke përfshirë kërkesat në bazat e të dhënave dhe kopjet e dokumenteve të lëshuara.

5. Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave sipas këtij neni, i nënshtrohet rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Komisioni ose Kolegji i Apelimit merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme ose, aksidentale, si dhe nga humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në format elektronik, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi, në përputhje me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale.

6. Brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, çdo organ shtetëror ose ent publik detyrohet të bashkëpunojë me Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit për dorëzimin, aksesin dhe verifikimin e të dhënave, fakteve ose rrethanave. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi, vonesat ose sjellja e papërshtatshme e procesit të verifikimit raportohet ne zyrën e prokurorisë si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal dhe përbën shkelje disiplinore.

7. Komisioni, Kolegji i Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejtën të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar brenda kuadrit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe kanaleve diplomatike. Kërkesat trajtohen nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Neni 44

Përfundimet bazuar në fakte

Nëse subjekti i rivlerësimit nuk paraqet provat sipas nenit 85 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe kur provat që disponojnë janë të paplota, Komisioni dhe Kolegji i Apelimit, marrin vendim mbi bazën e provave që disponojnë, vlerësimin të çështjeve në tërësi, si dhe mbi bindjen e tyre të brendshme.

Neni 45

Barra e provës

1. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit pa kaluar kufijtë e kompetencave tyre.

2. Nëse relatori arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 42 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

Neni 46

Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve

1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me komponentët e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejtë institucionet e rivlerësimit. Institucioni është i detyruar të kontrollojë nëse informacionin është dhënë nga një person i njohur ose anonim.
2. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore sipas komponentëve të rivlerësimit, veçanërisht mbi veprimin apo praktikën e dyshuar, pasojat ligjore dhe rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit.
3. Heqja dore nga raportimi i personit, nuk passjell pushimin e hetimit, nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit çmon se veprimi apo praktika e dyshuar, përmbajnë shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit kryesisht.
4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit publikojnë një model denoncimi me qëllim që të lehtësohet paraqitja e informacionit nga publiku.
5. Të drejtat dhe interesat e personave që denoncojnë mbrohen automatikisht në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme sipas standarteve të parashikuara në ligji nr. 60 /2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 47

Seanca dëgjimore

1. Relatori e fton subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative. Vëzhguesit ndërkombëtarë njoftohen paraprakisht për zhvillimin e seancës dëgjimore.
2. Seanca dëgjimore e Komisionit është publike. Regjistrimi nga televizioni dhe radio nuk lejohen.
3. Komisioni, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, të një pale tjetër ose me iniciativën e tij, mund të mos lejojë pjesëmarrjen e publikut, gjatë gjithë procedurës ose në një pjesë të saj, si më poshtë:
 - a) për të mënjanuar ose ulur rrezikun për rendin publik ose sigurinë kombëtare;
 - b) për të mbrojtur fshehtësinë e jetës private të subjektit të rivlerësimit ose një personi tjetër.
4. Komisioni ka të drejtë të marrë në pyetje subjektin e rivlerësimit. Nëse ai pranon të përgjigjet mund t'i drejtojë pyetje edhe vëzhguesi ndërkombëtar. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve. Pyetjet mund të përfshijnë njohuritë dhe aftësitë praktike në fushën e së drejtës ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën vitin e fundit.
5. Komisioni ka të drejtë të kufizojë në mënyrë të arsyeshme kohën e parashikuar për tu shprehur nga ana e subjektit të rivlerësimit.
6. Komisioni vlerëson çdo mendim ose gjetje të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar.

7. Bisedimet për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit zhvillohen me dyer të mbyllura në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar. Vendimi i Komisionit merret me votim të hapur, dhe me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të trupit gjykues. Nëse gjatë vendimmarrjes ka qëndrime të ndryshme nga ai i shumicës, komisionieri i mbetur në pakicë arsyeton me shkrim mendimin e tij. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të shkruajë një mendim ndryshe/paralel që i bashkohet vendimit. Procesverbali i bisedimeve të çështjes mbahet nga personeli i regjistrimit të Komisionit.

8. Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore.

9. Vendimi me shkrim i njoftohet subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.

Neni 48

Dorëheqja

1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të dorëhiqet jo më vonë se shpallja e vendimit të Komisionit të parashikuar në nenin 47, paragrafi 8 i këtij ligji. Dorëheqja paraqitet me shkrim dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare sipas nenit 7 paragrafi 1 të ligjit nr. 8097/1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shteti”.

Neni 49

Vendimi i Komisionit

1. Relatori i çështjes arsyeton me shkrim vendimin e Komisionit.

2. Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe urdhëruese.

3. Hyrja e vendimit përmban:

a) emërtimin zyrtar të Komisionit;

b) trupi që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësi administrativ;

c) orën dhe vendin e vendimit të dhënë;

d) emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, si dhe përfaqësuesve të tij;

f) mendimin e subjektit të rivlerësimit dhe/ose të përfaqësuesit të tij.

4. Pjesa përshkuese-arsyetuese përmban:

a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues;

b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet;

c) raportin dhe rekomandimin e relatorit;

d) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi.

5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban:

a) alternativën që ka vendosur trupa gjykuese;

b) Nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore;

c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij.

Neni 50

Masat disiplinore

1. Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit:
 - a) konfirmimi në detyrë;
 - b) pezullim nga detyra për një periudhë 1 (një) vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.
 - c) shkarkimin nga detyra;
2. Në rast se subjektet e rivlerësimit sipas nenit 179/b paragrafi 4, fjalia e dytë kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, Komisioni mund të vendosë:
 - a) emërimin si gjyqtar ose prokuror në përputhje me dispozitat e ligjit për statusin ose
 - b) refuzimin e emerimit si gjyqtar ose prokuror në përputhje me dispozitat e ligjit për statusin;

Neni 51

Konfirmimi në detyrë⁹

1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme:
 - a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 26 paragrafi 5, pika “a”, e këtij ligji;
 - b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 32 paragrafi 2 të këtij ligji;
 - c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 37, pika “a” e këtij ligji.
2. Komisioni arsyeton në vendimin e tij se subjekti i rivlerësimit konsiderohet i përshtatshëm për të vazhduar ushtrimin e detyrës, duke shpjeguar arsyet e mosmarrjes së ndonjë mase disiplinore.
3. Pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit për statusin, ose për vlerësim profesional dhe etik në rast se evidenton shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Organi kompetent fillon pa vonese shqyrtimin e shkaqeve sipas ligjit për Statusin. Ky vendim nuk është i ankimeshëm.

Neni 52

Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit

1. Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhë 1 (një) vjeçare i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se janë evidentuar mangësi në aftësitë e tij profesionale sipas nenit 37, pika “b”.
2. Në rast se subjekti i rivlerësimit përfundon programin e trajnimit, Shkolla e Magjistraturës i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë rezultatet e provimit përfundimtar duke u shprehur nëse mangësitë janë mënjeluar, apo jo.

⁹Eshte perdorur termi “Konfirm ne Detyre”si terminologji e perdor ne ligjin per nepunesin civil pas periudhes se proves.

3. Komisioni njofton subjektin e rivlerësimit brenda 10 ditëve të paraqesë një shpjegim me shkrim mbi arsyet e mospërfundimit me rezultate të kënaqshme të programit të trajnimit gjatë periudhës së pezullimit. Një kopje e këtij njoftimi i dërgohet vëzhguesit ndërkombëtar.

4. Komisioni pasi vlerëson në tërësi dokumentacionin e përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës dhe shpjegimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, vendos:

- a) të shtyjë periudhën e pezullimit për trajnim, por jo më shumë se 1 (një) vit;
- b) shkarkimin nga detyra.

Neni 53

Shkarkimi nga detyra

Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste:

a.kur rezulton se ka deklaruar deri në 200 % të ardhura të paligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të, sipas nenit 26 paragrafi 4,5.

b.kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës sipas nenit 32, paragrafi 3 i këtij ligji, që bën të pamundur vazhdimin e detyrës;

c.kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për komponentin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas neneve 32 dhe 26 të këtij ligji.

d. kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale sipas nenit 37 pika "c".

e. në rast se nga vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4 paragrafi 2 i këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cënuar besim publik të sistemi e drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësi të menjanimin të mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

Neni 54

Te drejtat e subjektit të rivlerësimit pas dhënies së vendimit të Komisionit

1. Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet *ex lege* nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimeve.

2. Gjatë periudhës së pezullimit subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje. Ai ka të drejtë të vizitojë rregullisht zyrën e tij, përfshirë adresën e tij elektronike zyrtare.

KREU VIII

APELIMI

Neni 55

Paraqitja e Ankimit

1. Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionieri Publik, 15 ditë nga data e vendimit të Komisionit.

2. Ankimi depozitohet në Komisionin që ka dhënë vendimin sipas nenit 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Neni 56

Njoftimi i Ankimit

Ankimi i njoftohet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 39 të këtij ligji dhe nenin 52 të Ligjit nr. 49/2012 “Mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Neni 57

Procesi gjyqësor

1. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimeve kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48 /1; 49, 51, 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.
2. Në rastin e ankimit nga komisioneri publik, Kolegji i Apelimeve e gjykon çështjen në seancë publike.

Neni 58

Vendimi i Kolegjit të Apelimit

1. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apelimeve vendos:
 - a) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit;
 - b) ndryshimin e vendimit të Komisionit;
 - c) prishjen e vendimit të Komisionit.
2. Kolegji i Apelimeve, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.
3. Vendimi i Kolegjit të Apelimeve që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm *ex lege*.

Neni 59

Rivendosja në afat e së drejtës për ankim

1. Nëse subjekti i rivlerësimit ose komisioneri publik nuk paraqesin ankimin brenda afatit, ata kanë të drejtë të kërkojnë rivendosjen në afat të ankimit pranë Komisionit, brenda 15 ditëve nga data që vijnë në dijeni për shkakun e humbjes të së drejtës, por jo më vonë se afati i parashikuar në nenin 179/b, paragrafi 9 i Kushtetutës.
2. Kërkesa pranohet vetëm nëse ankimi nuk është paraqitur në kohë, për shkaqe legjitime dhe të arsyeshme.

KREU IX

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 60

Buxheti i Komisionit dhe i Kolegjit të Apelimeve

Buxheti i institucioneve parashikohet nga ligji për buxhetin e shtetit për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit. Institucionet paraqesin përkatësisht çdo vit kërkesat për buxhet shtesë në Ministrinë e Financave.

Neni 61

Selia e organeve

1. Komisioni fillon aktivitetin në selinë pranë ndërtesës së Ministrisë së Drejtësisë. Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimeve me Komisionin, mund të marrë me qira, hapësira të mjaftueshme shtesë, për zyrat në zonën e Tiranës dhe të transferojë selinë e tij.
2. Komisioneri Publik fillon aktivitetin në selinë pranë ndërtesës së Gjykatës së Shkalles së Parë të Krimeve të Rënda
3. Kolegji i Apelimeve fillon punën në selinë pranë ndërtesës së Gjykatës Kushtetuese. Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimeve me mbledhjen e gjyqtarëve, mund të vendosë të marrë me qira hapësirë të mjaftueshme shtesë për zyrat në zonën e Tiranës dhe të transferojë selinë e tij.

Neni 62

Auditimi financiar

Auditimi financiar i Komisionit, Komisionerit Publik dhe Kolegjit të Apelimeve kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 63

Dispozitë kalimtare për vlerësimin e aftësive profesionale

1. Vlerësimet e aftësive profesionale të kryera nga Inspektorati në datën e fillimit të funksionimit të Komisionit dhe të Kolegjit të Apelimeve, i dorëzohen këtyre të fundit. Protokollin e dorëzimit të dokumenteve ligjore dhe raporteve në lidhje me vlerësimet për aftësitë profesionale, nënshkruhen nga Kryeinspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe një Komisioner i zgjedhur me short.
2. Vlerësimet për aftësitë profesionale nga Inspektorati në datën e fillimit të funksionimit të Komisionit ose Kolegjit të Apelimeve vazhdojnë të vlerësohen nga Inspektorati deri në fillimin e funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit “Për Statusin”. Me fillimin e funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çdo çështje e papërfunduar, pavarësisht nga faza e vlerësimit, i dorëzohet nga Kryeinspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë përfaqësuesit të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Protokollin e dorëzimit nënshkruhet nga të dyja palët.
3. Lista e subjekteve të rivlerësimit për të cilët nuk ka filluar vlerësimi për aftësitë profesionale nga Inspektorati, në datën e fillimit të funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i dorëzohet këtij të fundit në pajtim me dispozitat e Ligjit “Për mirëqeverisjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë” Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen vlerësimin për aftësitë profesionale për të vlerësuarit e mbetur pa vlerësim, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 64
Shkrirja e Institucioneve

1. Institucionet pushojnë së funksionuari sipas Neni179/b, paragrafi 9, i Kushtetutës.
2. Përveç rasteve kur autorizohet ndryshe nga Kuvendi, mandati i vetëm që vazhdon është ai i Sekretarit të Përgjithshëm, i cili ka një personel i mjaftueshëm për të përmbushur detyrat.

Neni 65
Dispozita të fundit

30 (tridhjetë) ditë pas krijimit të institucioneve, mbledhja e komisionerëve ose gjyqtarëve, miraton rregulla për veprimtarinë e institucioneve të rivlerësimit.

Neni 66
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

KRYETARI
ILIR META